



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11.5.2023

Nr: 486

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE DHE SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 252 ID, 253 ID, 254 ID, 255 ID, 286 ID NGA DEPUTETI ZJ. ALBANA VOKSHI, 327 ID, 329 ID, 332 ID NGA DEPUTETI Z. FLAMUR NOKA, 357 ID, 358 ID NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË", 333 ID, 352 ID, 353 ID, 371 ID, 372 ID, 373 ID, 376 ID, 377 ID, 378 ID, 382 ID, 384 ID, 388 ID, 389 ID NGA Z. IVI KASO DHE 354 ID NGA MONITORUESIT, PËR SHPËRDORIM TË BURIMEVE PUBLIKE, PËR PERIUDHËN 28 PRILL-04 MAJ 2023

Sot, më datë 11.5.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, Bashkia Tiranë, Bashkia Devoll, Bashkia Kavajë, Bashkia Libohovë, Bashkia Mallakastër, Bashkia Tropojë.
Z. Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq;
Zj. Emiriana Sako, Kryetar i Bashkisë Durrës;
Zj. Amarilda Thërrmija, Drejtor i Zyrës Vendore Arsimore, Durrës;
Zj. Bora Muzhaqi, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
Artur Bushi, Kryetar dhe kandidat i Bashkisë Krujë;
Z. Ervin Demo, Kryetari dhe kandidat i Bashkisë Berat;
Z. Blendi Gonxhe, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
Z. Gjon Gjonaj, Kryetar dhe kandidat i Bashkisë Pukë;
Z. Nikoll Doda, Oficer i Patrullës së Përgjithshme në Komisaratin e Policisë Kurbin, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë;
Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë;
Z. Ermal Kapllani, Drjetor i Ploicisë Bashkiake Tiranë;
Kryetar i Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS);

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

Punonjës i administratës, Fier
Z. Ardian Gurma, Kryetar i Bashkisë Sarandë;
Partisë Socialiste të Shqipërisë, Njësia 11;
Zj. Eglantina Zere, Drejtori i Tirana Parking;
Z. Niko Peleshi, Ministër i Mbrojtjes;
Zj. Belinda Balluku Zëvendëskryeministër;
Z. Bujar Dema;
Z. Benet Beci, Kandidat për kryetar në bashkinë Shkodër.

OBJEKTI: Vlerësimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve si dhe shqyrtimi administrativ i denoncimeve nr. 252 ID, 253 ID, 254 ID , 255 ID, 286 ID nga deputeti zj. Albana vokshi, 327 ID, 329 ID, 332 ID nga deputeti z. Flamur Noka, 357 ID, 358 ID, nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”, 333 ID, 352 ID, 353 ID, 371 ID, 372 ID, 373 ID, 376 ID, 377 ID, 378 ID, 382 ID, 384 ID, 388 ID, 389 ID nga z. Ivi Kaso dhe 354 ID, nga monitoruesit, për shpërdorim të burimeve publike, për periudhën 28 prill- 4 maj 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19 pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, e pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

KREU I

Gjatë periudhës 28 prill deri më 4 maj 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike (shkresë+email), janë raportuar gjithsej 123 aktivitete, nga 42 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se nga këto, 11 aktivitete të zhvilluara nga 8 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor.

Për aktivitetet e raportuara në tejkalim të afatit ligjor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kryer shqyrtimin administrativ si vijon:

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

1. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Ftesë për pjesëmarrje në panairin e VIII të karrierës, të organizuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës”, raportuar në datë 3.5.2023 për tu zhvilluar në datë 4.5.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet “Panairi i vlerave “Art, zeje, sport”, raportuar në datën 2.5.2023 për t’u zhvilluar në datën 5.5.2023

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier nëpërmjet email-it të datës 8.5.2023 dhe shkresës protokolluar me tonën me nr. 4835 datë 9.5.2023 ka nisur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: “*DRAP Fier, prej fillimit të detyrimit për raportim e në vijim ka planifikuar dhe organizuar vetëm një veprimtari me karakter publik. Kjo veprimtari me temë "Panairi i vlerave 'Art, zeje, sport' është organizuar në të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar në vend, në kuadër të programit JOM (jashtë orarit mësimor) që zbatohet në një numër institucioneve arsimore të vartësisë. Veprimtaria ka karakter ekskluzivisht edukativ dhe është në përputhje me misionin dhe objektiva të DRAP Fier.*

Në datën 25 prill 2023 DRAP Fier ka raportuar mbi zhvillimin e kësaj veprimtarie të planifikuar për datën 4 maj 2023. Ky raportim është në përputhje me vendimin e Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020. Në datën 2 maj 2023, gjatë përgatitjeve për zhvillimin e veprimtarisë, u konsultuam me parashikimin e motit për datën e planifikuar 4 maj. Për datën 4 maj parashikohej mot me reshje dhe i papërshtatshëm për grumbullim masiv në një mjedis krejt të hapur (sheshi qendror i qytetit të Fierit) të një numri të madh fëmijësh që vijnë nga tri qarqet e jugut të vendit, të cilët do të ekspozonin punime në pikturë, në zejtarë, të shfaqnin pjesë teatrale, koreografike dhe muzikore. Në kushtet e parashikuara si më sipër aktiviteti ishte i pamundur të zhvillohej, për këtë arsye u vendos që të shtyhej data e aktivitetit për një ditë më vonë, me 5.5.2023. Në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike në KQZ, nuk kishte opsion për modifikimin e të dhënave për veprimtarinë e

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

deklaruar me 25 prill. Për të përmbushur detyrimin për raportim, u aplikua tek "Shto aktivitet", për të njëjtin aktivitet të raportuar me 25 prill (8 ditë më parë ose 11 ditë para organizimit të veprimtarisë)."

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, si dhe nga hetimi i kryer, rezulton që Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, ka kryer raportimin lidhur me këtë aktivitet në datë 25 prill 2023 për tu zhvilluar datë 4 maj 2023. Për shkak të paqëndrueshmërisë së kushteve klimatike kanë vendosur të shtynjë aktivitetin ditën e fundit duke e riraportuar atë në mungesë të një aplikacioni shtyrje. Ndodhur në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson që raportimi është kryer brenda afatit ligjor dhe nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

3. Bashkia Tiranë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktiviteti "Inspektim/Inagurimi: Godina 18 tek Lagjia 5 Maj", raportuar në datë 30.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 6.4.2023
2. Aktiviteti "Vizitë në Liqenin e Farkës", raportuar në datë 1.5.2023 për tu zhvilluar në datë 5.5.2023

Lidhur me aktivitetin e parë, "Inspektim/Inagurimi: Godina 18 tek Lagjia 5 Maj", Bashkia Tiranë nëpërmjet email-it të datës 2.5.2023 ka nisur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *Aktiviteti i raportuar në ndërfaqe për t'u zhvilluar datë 6.4.2023 është një lapsus në hedhjen e të dhënave, pasi aktiviteti do të zhvillohet datë 6.5.2023".*

Për aktivitetin e dytë, "Vizite ne Liqenin e Farkës", Bashkia Tiranë nëpërmjet email-it të datës 9.5.2023 ka nisur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *"Kemi të bëjmë me një vonesë një ditë për raportimin e aktivitetit, e cila ka ardhur si pasojë e ngarkesës në ndërfaqen e raportimeve dhe është riprovuar përsëri ditën e nesërme, më datë 1.5.2023. Pra në çdo rast qëllimi i bashkisë Tiranë nuk është mosraportimi i aktivitetit apo raportimi në shkëlqje të afatit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor."*

Për aktivitetin e parë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ-së duke qenë se kemi të bëjmë me një gabim material. Në këto kushte, kur veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor të raportimit, nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

Për aktivitetin e dytë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e çështjes dhe nisur nga pretendimet e Bashkisë Tiranë, konstaton se vonesa ka ardhur si pasojë e problematikës me ndërfaqen e raportimeve. Për këtë arsye, duke marrë shkak edhe

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

nga problematika teknike që ka pasur ndërfaqja këtë periudhë, vlerësojmë se nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

4. Bashkia Devoll, ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktiviteti *“Takim/Analizë Pune me stafin e Bashkisë”*, raportuar në datë 4.5.2023 për tu zhvilluar në datë 8.5.2023
2. Aktiviteti *“Vënie në skenë e veprës e madhe është gjëma e mëkatit” me shkrimtar Mitrush Kutelin, nga aktori i njohur Ligoraq Riza*, raportuar në datë 30.4.2023 për tu zhvilluar në datë 4.5.2023

Bashkia Devoll nëpërmjet email-it të datës 5.5.2023 ka sqaruar se: *Sa i përket aktivitetit “Takim/Analizë Pune me stafin e Bashkisë”, për shkak të agjendës të ngarkuar të Kryetarit e kishim të pamundur ta linim në datë 9.5.2023. Sa i përket Aktiviteti “Vënie në skenë e veprës e madhe është gjëma e mëkatit” me shkrimtar Mitrush Kutelin, nga aktori i njohur Ligoraq Riza”, edhe në këtë aktivitet ishim të detyruar ti përshtateshim agjendës së aktorit i cili e kishte të pamundur të vinte në datë 5.5.2023 për shkak se kishte një shfaqje tjetër në këtë datë”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se lidhur me aktivitetin *“Takim/Analizë Pune me stafin e Bashkisë”*, përbën veprimtari administrative, jo publike të institucionit për të cilën nuk ka detyrim të raportojë në ndërfaqe.

Lidhur me aktivitetin *“Vënie në skenë e veprës e madhe është gjëma e mëkatit” me shkrimtar Mitrush Kutelin, nga aktori i njohur Ligoraq Riza*, vlerëson se Bashkia Devoll nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këtë aktivitet për shkak se është një aktivitet artistik dhe organizuar në bashkëpunim me aktorin e shfaqjes i cili e kishte të pamundur të planifikonte për shkak të agjendës së tij. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Bashkia Kavajë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti *“Në monumentin e dëshmorëve në fshatin çetë, organizohet ceremonia e nderimit kushtuar ditës së dëshmorëve.”*, raportuar në datë 30.4.2023 për t’u zhvilluar në datë 5.4.2023.

Bashkia Kavajë nëpërmjet email-it të datës 2.5.2023 ka sqaruar se: *“Për shkak të përditësimit të fundit që ju bë faqes së KQZ është bërë një lapsus nga ana ime. Data e zhvillimit të aktivitetit është 5.5.2023”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se është kryer një gabim gjatë raportimit në ndërfaqe, fakt ky që provohet edhe nga tematika e raportimit të kryer, aktivitet “ceremoni” që zhvillohet në kuadër të ditës së Dëshmorëve 5 Majit. Gjithashtu, nisur nga tematika e veprimtarisë që i kushtohet ditës së Dëshmorëve, nuk është veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim.

6. Bashkia Libohovë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Dita e dëshmorëve”, raportuar në datë 2.5.2023 për tu zhvilluar në datë 5.5.2023.

Bashkia Libohovë nëpërmjet email-it të datës 8.5.2023 ka sqaruar se: *“Njoftimi për aktivitetin e datës 5.5.2023 (ditës së dëshmorëve) është raportuar në datën 2.5.2023 pasi data 29-30 prill dhe 1 maj ishin ditë pushimi. Për këtë arsye nuk u zbatua detyrimi për të raportuar 5 ditë më parë sesa zhvillimi i aktivitetit”.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se nisur nga tematika e veprimtarisë që i kushtohet ditës së Dëshmorëve, nuk është veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim.

7. Bashkia Mallakastër ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Homazhe në varrezat e Dëshmorëve”, raportuar në datë 1.5.2023 për tu zhvilluar në datë 5.5.2023.

Bashkia Mallakastër nëpërmjet email-it të datës 10.5.2023 ka sqaruar se: *“Bashkia Mallakastër ka bërë raportimin për Homazhe në nderim të 5 Majit, më datë 1.5.2023. Duke nisur dhe nga fakti që ka pasur data pushimi, festa zyrtare dhe të gjendur në kushte të tilla raportimi është bërë pak me vonesë. Kërkojmë mirëkuptimin tuaj, pasi data 5 Maji, është një datë historike dhe kujtohet dhe nderohet nga të gjitha institucionet. Institucioni jonë e ka raportuar në limit të afatit kohor, konkretisht data 1.5.2023, kërkojmë mirëkuptimin tuaj.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se nisur nga tematika e veprimtarisë që i kushtohet ditës së Dëshmorëve, nuk është veprimtari me karakter publik, që ka detyrim për raportim.

8. Bashkia Tropojë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktiviteti *“Festivali i përvitshëm “Sofra Dardane”*, raportuar në datë 2.5.2023 për tu zhvilluar në datë 4.5.2023.
2. Aktiviteti *“Promovimi i vlerave turistike, artit, kulturës dhe gastronomisë”*, raportuar në datë 2.5.2023 për tu zhvilluar në datë 5.5.2023.

Bashkia Tropojë nëpërmjet email-it të datës 2.5.2023 ka sqaruar se: *“Ju njoftojmë se për arsye teknike nuk kemi mundur të raportojmë javën e kaluar për disa aktivitete që do të zhvillohen në Tropojë, dhe raportimin e tyre e bëmë të mundur sot, te ndërfaqja e www.aktivitete.kqz.gov.al*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se, sipas nenit 4 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në rast se institucioni e ka të pamundur teknikisht aksesimin e ndërfaqes, mund të dërgojë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor. Megjithatë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton Bashkinë Tropojë, sepse vonesa ka ardhur si pasojë e vështirësisë të aksesimit me sistemin dhe për këtë arsye vlerëson të pushoj procedimin administrativ.

KREU II

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka administruar denoncime për organizimin e veprimtarive të ndaluara dhe përdorimin e burimeve publike, sipas kufizimeve të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave dhe materialeve fotografike si dhe filmike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit

të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, vijoi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion sqarues në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Institucionet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

1. Denoncimet e regjistruar me nr. 357 ID dhe 358 ID, ndaj Z. Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq dhe Këshillit Bashkiak të Bashkisë Maliq për 2 (dy) veprimtari publike për të cilat pretendohet si më poshtë vijon:

- Denoncim regjistruar me nr. **357 ID**, i administruar nëpërmjet adresës së e-mail denoncime@kqz.gov.al, i datës 28.4.2023, nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë" ku pretendohet se: *"Këshilli Bashkiak i Bashkisë Maliq, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, me vendimin nr. 34, datë 29.3.2023 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë, me qëllim "Mbrotjtjen dhe Përfshirjen Sociale për të Moshuarit", ka miratuar përdorim fondesh buxhetore dhe shtim numër punonjësish për ngritjen e një qendre sociale për të moshuarit në Njësinë Administrative Libonik, Bashkia Maliq. Veprimet e Kryetarit të Bashkisë Maliq dhe Këshillit Bashkiak për miratimin e përdorimit të fondeve buxhetore me qëllim përfitimin e një kategorie të caktuar, konkretisht ngritjen e një qendre sociale për moshën e tretë, në Njësinë Administrative Libonik, Bashkia Maliq janë bërë brenda periudhës së ndalimit të parashikuar*

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

nga neni 91 te Kodit Zgjedhor, dhe si të tilla janë në kundërshtim flagrant me parashikimet e nenit 91 dhe 92 te Kodit Zgjedhor. Konkretisht neni 91, në pikën 4 të tij”.

- Denoncim, regjistruar me nr. **358 ID**, i datës 28.4.2023 nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” ku pretendohet se “Këshilli Bashkiak i Bashkisë Maliq, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, me vendimin nr. 371, datë 29.3.2023 “Për miratimin e dhënies me qira të pasurisë të pafrytshme nr. 597/1, zonë kadastrale 3803, sipërfaqe 65.417 m2, fshati Vloçisht, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq”, si edhe vendimin nr. 382, datë 29.3.2023 “Për miratimin e dhënies me qira të tokës bujqësore të pandarë, nr. 711, zonë kadastrale 3496, fshati Sovjan, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq”. Veprimet e Kryetarit të Bashkisë Maliq dhe Këshillit Bashkiak për dhënien me qira të tokave bujqësore, me qëllim zhvillimin ekonomik dhe përfitimin e një kategorie të caktuar, konkretisht banorët e fshati Vloçisht, Njësia Administrative Libonik, bashkia Maliq për sipërfaqen e tokës 65 417 m² si edhe fshati Sovjan, Njësia Administrative Pirg, bashkia Maliq, për sipërfaqen e tokës 31 900 m², bërë këto brenda periudhës së ndalimit të parashikuar nga neni 91 të Kodit Zgjedhor, janë në kundërshtim flagrant me parashikimet e nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe konkretisht me nenin 91, në pikën 4 të tij.

Bashkisë Maliq i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, për denoncimet të regjistruar me nr. 357 ID, dhe 358 ID, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 5.5.2023, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Maliq ndër të tjera bën me dije se: “Përsa i përket ankesës së parë të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, (denoncimi nr. 357 ID) mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Maliq, nr. 34, datë 29.3.2023 “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit të përbashkët të Bashkisë Maliq dhe Këshillit të Qarkut Korçë, me qëllim “Mbrotjtjen dhe Përfshirjen Sociale për të Moshuarit ” ka miratuar përdorim fondesh buxhetore dhe shtim numër punonjësish për ngritjen e një qendre sociale për të moshuarit në Njësinë Administrative Libonik, Bashkia Maliq, ju sqarojmë se për këtë vendim **Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr. 338/1 datë 18.4.2023, nuk e ka konfirmuar bazueshmërinë ligjore të tij për pasojë ky vendim nuk ka sjellë pasoja juridike dhe nuk është i zbatueshëm.** Për këtë arsye ankesa e subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk qëndron.

Për sa i përket ankesës së subjektit Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (denoncimi nr. 358 ID) mbi vendimet e miratuara të Këshillit të Bashkisë Maliq, konkretisht: Vendimi nr. 37, datë 29.3.2023 “Për miratimin e dhënies me qira të pasurisë të pafrytshme nr. 597/1, zonë kadastrale 3803, sipërfaqe 65 417 m2, fshati Vloçisht, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq” dhe nr. 38, datë 29.3.2023 “Për miratimin e fillimit të procedurës për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë, nr. 711, Zonë Kadastrale 3496, fshati Sovjan, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq”, sqarojmë se nuk jemi në

kushtet e nenit 91, pika 4 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, pasi pasuritë e mësipërme nuk po privatizohen dhe nuk po i jepen si shpërblim një kategorie të caktuar të popullsisë, ashtu si pretendon subjekti ankues.

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

Me vendimin nr. 37, datë 29.3.2023 "Për miratimin e dhënies me qira të pasurisë të pafrytshme nr. 597/1, zonë kadastrale 3803, sipërfaqe 65.417 m², fshati Vloçisht, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq", bazuar në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar, kreu I, pika 6, gërma "c", Kreu II, pika 1, Kreu III, pika 1, gërma "c", si dhe pikës 2, 3, 4, 17 dhe 34 të udhëzimit nr. 13, datë 26.04.2018 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës e mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" të ndryshuar", **Këshilli i Bashkisë Maliq ka miratuar në parim dhënien me qira të kësaj pasurie, e cila referuar legjislacionit të sipërcituar do të jepet në bazë të procedurave të konkurrimit, pra nuk është favorizuar me anë të këtij vendimi një kategori e caktuar popullsie.**

Me vendimin nr. 38, datë 29.3.2023 "Për miratimin e fillimit të procedurës për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë, nr. 711, Zonë Kadastrale 3496, fshati Sovjan, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq", bazuar në Ligjin Nr. 8312 datë 26.3.1998 "Për Tokat Bujqësore të Pandara", VKM Nr.531, datë 21.08.1998 "Për Tokat Bujqësore të Pandara", i ndryshuar, si dhe udhëzimit Nr. 1, datë 18.7.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" Kreu I, pika 2, **Këshilli i Bashkisë Maliq ka miratuar në parim dhënien me qira të kësaj pasurie, e cila gjithashtu do të jepet në bazë të procedurave të konkurrimit.**

Për sa më sipër themi se **vendimet e mësipërme të Këshillit të Bashkisë Maliq, janë miratime në parim për nisjen e procedurave për dhënien me qira të pasurive respektive, të cilat do të nënshtrohen procedurave të konkurrimit sipas legjislacionit në fuqi, dhe më pas do të lidhet kontrata e qirasë me subjektin që do të rezultojë fitues nga procedura e konkurrimit. Pra me vendimet e mësipërme Këshilli i Bashkisë nuk po privatizon apo jep si shpërblim pasuritë e mësipërme në favor të një kategorie të caktuar popullsie. Theksojmë gjithashtu se nga ana e bashkisë Maliq ende nuk ka nisur procedura për dhënien me qira të pasurive të miratuara me vendimet e mësipërme."**

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e bashkisë Maliq.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, vlerësojmë se:

Pas administrimit të fakteve dhe provave të administruara nga ana e denoncuesit dhe të denoncuarit, pasi u dëgjuan të gjitha pretendimet e palëve, vlerësojmë se, referuar nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se "Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

heqjen e taksave, vendosjen e amnitive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore”.

Në qoftë se bëjmë leximin “fjalë për fjalë” të nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, “deri në formimin e qeverisë së re” duket se legjislatori e kufizon “miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara” vetëm për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend. Sa më sipër, në mungesë të një dispozite ndaluese, nxjerrja e kësaj kategorie aktesh për zgjedhjet vendore, nuk mund mund të jenë objekt shqyrtimi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Palët në këtë proces nuk mund të procedohen për miratimin e akteve, që në momentin kur janë nxjerrë, nuk janë parashikuar nga Kodi Zgjedhor si shkelje administrative. Në këtë kuadër, miratimi i këtyre akteve prej të denoncuarit mbetet brenda parashikimeve të ligjit.

Për sa më sipër në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjate procesit administrativ, rezulton se objekti për këto denoncime nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2. Denoncimet e regjistruar me nr. 371 ID, 372 ID, 352 ID, 388 ID ndaj bashkisë Durrës dhe ndaj Zj. Emirjana Sako kryetare e bashkisë dhe kandidate, për 4 (katër) veprimtari publike të ndaluara për të cilat pretendohet si më poshtë vijon:

- Denoncim regjistruar me nr. **371 ID**, dërguar me shkresën nr. 160 prot., datë 29.4.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4562 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso i cili pretendon se: *“Tenderim i milionave eurove për asfalt elektoral e punime të tjera infrastrukturore, abuzim me portin dhe me fondet. Një nga përfitueset është edhe zj. Emirjana Sako, përmes bashkisë Durrës”.*

Më datë 5.5.2023 bashkia Durrës ka informuar se *“Bazuar në ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në nenin 23, përcaktohen funksionet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike ku ndër të tjera thuhet se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore”. Këto janë detyra funksionale të Ndërmarrjes “Rruga” të cilat ushtrohen në çdo kohë, në çdo rrugë të qytetit dhe njësive administrative pavarësisht jemi në fushatë zgjedhore apo jo.*

Punimet realizohen sipas parashikimeve buxhetore të miratuara nga Këshilli Bashkiak Durrës për çdo sektor, pjesë të Ndërmarrjes Rruga. Rikonstruksioni i rrugës “Marseja”, “Napoli” dhe “Hideve” janë kryer nga Ndërmarrja “Rruga”, me fondet e miratuara në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023”.

Ndërsa për sa i përket rrugës “Valbona” në Njësinë Administrative Rrashbull, saktësojmë se rikonstruksioni i kësaj rruge është bërë në vitin 2022 me fonde dhe procedura të ndjekura nga

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

Këshilli i Qarkut Durrës. Takimi i zhvilluar me banorët e zonës është një takim në kuadër të fushatës elektorale, por në këtë takim nuk ka asnjë promovim të investimeve të kryera për fonde të planifikuara pas datës 13 janar 2023, aq me tepër sikurse sqaruar më lart kjo është rrugë është rikonstruktuar në vitin 2022. Përsa i përket pastrimit të zonës bregdetare nga papastërtitë dhe leshteriku, sqarojmë se kjo është një punë sistematike që kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Plazh, si një detyrë funksionale që kjo ndërmarrje ka. Ky pastrim madje intensifikohet më tepër në prag të sezonit turistik në kuadër të përgatitjeve që bëhen çdo vit për fillimin e këtij sezoni.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin **të regjistruar me nr. 371 ID**, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë u paraqit përfaqësuesi i bashkisë i cili konfirmoi edhe njëherë për sa kanë informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shkresërisht.

Në përfundim të hetimit administrativ për **denoncimin e regjistruar me nr. 371 ID**, konstatojmë se bëhet fjalë për një aktivitet funksional të z. Emiriana Sako, e cila në cilësinë kryetarit aktual të bashkisë Durrës, ka përmbushur detyrat që rrjedhin nga ligji. Denoncuesi pretendon se në faqen facebook **të Kryetares së Bashkisë**, promovohen investime, me fonde të vëna rishtazi. Referuar nenit 3, pika 1.1 shkronja "a" dhe "b", të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator "ku parashikohet se "1. 1 "veprimtari të ndaluara për tu promovuar" janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, **për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:**

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut,
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik".

Që të kemi shkeljen e kësaj dispozite, duhet të vërtetohet se fondet e projekteve që promovohen, duhet të jenë vënë **"rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve"**. Gjatë hetimit rezultoi e provuar, se fondet për kryerjen e ketyre punimeve, janë vënë në dispozicion para periudhës së parashikuar nga ligji, duke mos konstatuar shkeljen e kësaj dispozite.

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

Gjithashtu, u vlerësua se postimet në **llogaritë personale** në rrjetin social “facebook” të kryetarëve të bashkisë, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Subjektet zgjedhore kanë karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit. Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale nga ana e subjekteve zgjedhore. Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përligjura. Postimet në llogaritë personale në rrjetin social “facebook” të subjektit zgjedhor, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objektit të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi, dhe si të tilla, nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve, për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike, interferon në liritë themelore, siç janë liria për tu shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për denoncimin me **nr. 371 ID** pasi nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe as të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

- Denoncim regjistruar me nr. **372 ID** dërguar me shkresën nr. 161 prot., datë 29.4.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4563 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso i cili pretendon se: *“Inagurim i shkollës « Dhosi Liperi » në Sukth, me pjesëmarrjen e kryetares së bashkisë së Durrësit njëkohësisht dhe kandidatës për këtë bashki zj. Sako dhe Ministres së Arsimit zj. Evis Kushi.”*

Më datë 5.5.2023 **bashkia Durrës** ka informuar se *“Me rastin e 7 Marsit Kryebashkiakja ka zgjedhur këtë shkollë për të takuar mësues dhe nxënësit, për ti uruar të gjithë arsimtarëve për punën e tyre fisnike me rastin e ditës së mësuesve, ky aktivitet është raportuar sipas ligjit në KQZ dhe nuk kemi pasur asnjë njoftim nga ky institucion për të mos e zhvilluar. Aktiviteti mësipërm është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së në 28 Shkurt për në datën 7 mars.*

Më datë 5.5.2023, nëpërmjet e-mail ka sqaruar se **Zyra Vendore Arsimore Durrës**, ka sqaruar se: *“Ju bëjmë me dije se ZVAP Durrës nuk ka qenë në rolin e organizatorit apo pjesëmarrës në këtë aktivitet”.*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin të regjistruar me **nr. 372 ID**, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë u paraqit përfaqësuesi i bashkisë Durrës dhe përfaqësuesi i Zyrës Vendore Arsimore Durrës të cilët konfirmuan edhe njëherë përsa kanë informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shkresërisht.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin e regjistruar me **nr. 372 ID**, konstatojmë se bashkia Durrës, e ka raportuar aktivitetin e mësipërm më datë 28 Shkurt për t'u zhvilluar më datë 7 Mars, në përmbushje të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Referuar të dhënave të raportuara, është vlerësuar se aktiviteti ka qenë në përmbushje të kërkesave ligjore dhe është konsideruar si i lejuar për t'u kryer.

Denoncuesi pretendon se janë promovuar investime, me fonde të vëna rishtazi. Referuar nenit 3, pika 1.1 shkronja "a" dhe "b", të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator "ku parashikohet se: 1.1 *"veprimtari të ndaluara për tu promovuar"* janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, ***për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:***

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut,*
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik".*

Që të kemi shkeljen e kësaj dispozite, duhet të vërtetohet se fondet e projekteve që promovohen, duhet të jenë vënë **"rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve"**. Gjatë hetimit rezultoi e provuar, se fondet për kryerjen e ketyre punimeve, janë vënë në dispozicion para periudhës së parashikuar nga ligji, duke mos konstatuar shkeljen e kësaj dispozite. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për denoncimin me **nr. 372 ID** pasi nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe as të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

- **Denoncimet e regjistruar me nr. 352 ID, ndaj Zj. Emirjana Sako, Kryetar/kandidat i Bashkisë Durrës** dërguar me shkresën nr. 163 prot., datë 29.4.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4551 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso i cili pretendon se : *"Kryetaria e bashkisë Durrës, njëherazi kandidat e PS, për këtë bashki detyron në mënyrë të përsëritur, mësues dhe nxënës të institucioneve*

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

arsimore të qytetit, të marrin pjesë në takime elektorale. Gjimanzistë të shkollës "Naim Frasheri" janë detyruar të jenë prezentë në takimin elektorale të zj.Sako duke përdorur justifikimin se, aktiviteti do të ketë tematikë sociale, kulturore apo sportive, por që në fakt çdo diskutim ka qenë në kuadër të fushatës të ish Kryetares. Nën presionin e Drejtoreshës së Drejtorisë Arsimore, maturanët të gjimnazit "Gjergj Kastrioti", shkolla ende e pa përfunduar nga procesi i rindertimit, janë urdhëruar të jenë pjesë e takimit të Emiriana Sakos... Mësuesve të Durrësit i bëhet presion i vazhdueshëm me vendin e punës dhe nxënësve me vlerësimet në provime! Po ashtu, nxënës të shkollës "Migjeni" Durrës janë detyruar të jenë pjesë e fushatës së Kandidates së PS Sako duke mbjellë peme, në shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor e të Vendimeve të KQZ".

Më datë 4.5.2023, bashkisë Durrës dhe Zyrës Vendore Arsimore Durrës dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, për denoncimin e **regjistruar me nr. 352 ID**, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 5.5.2023 **bashkia Durrës** ka informuar se *"aktivitetet e zhvilluara nuk kanë cënuar aspak mbarëvajtjen e procesit mësimor. Sipas konfirmimit zyrtar të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, informohemi se shkollat e mesme në qytetin e Durrësit ndjekin një orar mësimor të përcaktuar. Ndjekja e rregullt e procesit mësimor është një detyrim për nxënësit dhe mësuesit, i cili ndiqet në mënyrë rigoroze nga të dyja palët, dhe nuk ka arsye që ky proces mësimor të pengohet për pjesëmarrje në fushatë elektorale. Pretendimet e parashtruara në denoncimet e lartpërmendura nuk përbëjnë fakte dhe prova të cilat mund të çojnë në shkeljen e dispozitave të Kodit Zgjedhor."*

Më datë 4.5.2023, **Zyra Vendore Arsimore Durrës (ZVA)**, *"ZVA, sikundër drejtoritë e shkollave, në asnjë rast nuk kanë organizuar, apo nuk janë angazhuar në realizimin e veprimtarive me karakter elektorale. ZVA ka bërë kujdes që ti kujtohet të gjitha institucioneve arsimore Vendimi Nr. 234, datë 20.4.2023, "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor, për zgjedhjet vendore 2023". Në këtë vijueshmëri ZVA po monitoron respektimin e procesit mësimor dhe frekuentimin e tij nga nxënësit e institucioneve arsimore nën juridiksionin e saj. Sigurojmë se nuk na rezulton që gjatë procesit mësimor të ketë nxënës të cilët të jenë përfshirë në veprimtari me karakter elektorale, sikundër e konsiderojmë tërësisht të pavërtetë që t'u jetë bërë presion mësuesve, apo nxënësve, me qëllim të ndonjë përfitimi elektorale, për një forcë të caktuar politike. Asnjë pretendim, ankesë, apo shqetësim nga mësues apo nxënës nuk rezulton të jëtë bërë prezent pranë ZVA Durrës".*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin të **regjistruar me nr. 352 ID**, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

- **Denoncimi i regjistruar me nr. 388 ID**, dërguar me shkresën nr. 162 prot., datë 29.4.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4564 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso i cili pretendon se: *"Kryeministri Edi Rama, Kryetarja e Bashkisë Durrës njëherazi Kandidate e Partisë Socialiste për këtë bashki, Ministri për Rininë Bora Muzhaqi kanë detyruar mësues dhe nxënës të institucioneve arsimore të qytetit, të marrin pjesë në takime elektorale. Mësuesve të Durrësit i bëhet presion i vazhdueshëm me vendin e punës dhe nxënësve me vleresimet në provime! Para disa ditësh janë detyruar të jenë pjesë e fushatës së Kandidates së PS Sako duke mbjellë pemë, në Eco Park në Porto Romano, në shkelje flagrante me Kodin Penal dhe vendimet e KQZ ndalojnë inagurimet, apo aktivitetet të tjera pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qeverisë."*

Më datë 5.5.2023 **bashkia Durrës** ka informuar se: *"Përsa i përket aktivitetit të zhvilluar për mbjelljen e pemëve ishte vet stafi drejtues pedagogjik dhe nxënës të shkollës që ftuan kryebashkiaken Emirana Sako për mbjelljen simbolike të disa pemëve me rastin e 20 vjetorit të kësaj shkolle. Ky aktivitet është zhvilluar ditë shtunë pra ditë pushimi duke mos cënuar në këtë mënyrë procesin mësimor theksojmë dhe njëherë që ishte ftesë e vetë shkollës për*

kryebashkiaken Sako.

Më datë 4.5.2023, **Zyra Vendore Arsimore Durrës (ZVA)**, ka sqaruar se *"ZVA, është vënë në dijeni të takimit të përmendur nga rrjetet sociale dhe mediat. Sigurojmë se nuk ka asnjë përfshirje të institucionit tonë në organizimin e veprimtarisë, sikundër sigurojmë se nga kërkesa që u është bërë shkollave për raportim, nuk rezulton të ketë përfshirje të nxënësve dhe mësuesve në veprimtari elektorale ose jo, brenda procesit mësimor. Asnjë pretendim, ankesë, apo shqetësim nga mësues apo nxënës nuk rezulton të jetë bërë prezent pranë ZVA Durrës"*

Më datë 5.5.2023 **Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët**, sqaron se *"Aktiviteti i përmendur nuk është veprimtari publike institucionale por një aktivitet politik me të rinj i organizuar nga "Partia Socialiste e Shqipërisë". Në këtë kontekst, pjesëmarrja në takim e zj. Muzhaqi nuk është angazhim institucional, sikundër nuk lidhet me ushtrimin e detyrave institucionale, por është kryer në cilësinë e saj si anëtare e partisë Socialiste të Shqipërisë"*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 5.5.2023, ora 12:30, ku u ftuan në këtë proces palët për denoncimin **të regjistruar me nr. 388 ID**, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në këtë seancë ishin të pranishëm përfaqësuesi i bashkisë Durrës si dhe Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore Durrës të cilët dhan deklaratimet e tyre lidhur me denoncimet objekt shqyrtimi me nr. 352 ID dhe 388 ID, ku mbështetën edhe një herë pretendimet e tyre dhe theksuan se veprimtaritë e zhvilluara nuk kanë cënuar aspak orarin mësimor si dhe nuk janë zhvilluar në ambinetet e shkollave.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin nr. 352 ID dhe nr. 388 ID, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia**”. Më tej, pika 2 e këtij neni parashikon se “**“burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit Brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.**

Po ashtu referuar vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në kuptim të këtij akti “veprimtari të ndaluar”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë ndër të tjera **përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim**”.

Për sa këto dispozita parashikojnë, shihet qartë se në mënyrë që të ndodhemi para shklejes duhet të provohet plotësimi i kushteve kumulative mbi përdorimin e **detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar**.

Nga verifikimi i provave dhe fakteve të administruara gjatë shqyrtimit administrativ, vlerësohet se provat e disponuara nuk përbëjnë një bazë të mjaftueshme për vërtetimin e shkeljes së pretenduar nga denoncuesi. Në çështjet objekt shqyrtimi nuk u arrit të provohej përdorimi i detyruar i nxënësve brenda orarit mësimor. Po ashtu theksohet se nga shqyrtimi i materialeve foto vërehet qartazi se këto aktivitete nuk janë zhvilluar në ambientet e shkollave, por evidentohet se janë zhvilluar në ambiente private.

Gjithashtu nga shqyrtimi i materialeve nuk arrihet të provohet se në këto aktivitete janë bërë premtime apo është bërë ofrimi i përfitimeve nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se për rastet objekt denoncimi regjistruar me nr. 352 ID dhe 388 ID, për bashkinë Durrës dhe Zyrën Vendore Arsimore Durrës, nuk u konstatua shkelje e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit. Për rrjedhojë vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ për palën e denoncuar.

3. Denoncimi i regjistruar me nr. 373 ID, ndaj bashkisë Krujë, për 1 (një) veprimtari të ndaluar, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncim me nr. 373 ID**, marrë me shkresën nr. 170 prot., datë 2.5.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4545 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso ku pretendohet se *“Bashkia e Krujës shpërndan grante për riparimin e ndërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti 3.5 vite pas fatkeqësisë natyrore dhe vetëm pak ditë përpara zgjedhjeve.*

Më datë 4.5.2023, bashkisë Krujë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin nr.373ID personi përgjegjës për komunikimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndër të tjera bën me dijë se *“Bashkia e Krujës ka qënë një prej bashkive më të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit ku në total për të gjitha nivelet e dëmit aplikuan 5000 familje në 6 njësi administrative. Procesi ka qënë mjaft dinamik dhe i vazhdueshëm pa ndërprerje pasi ky problem ka të bëjë me emergjencën nga fatkeqësia natyrore dhe familjet e demtuara nuk mund të presin. Madje për vonesat në procesin e rindërtimit është ankuar edhe subjekti ankimes i cili në këtë rast ankohet për të kundërtën.*

*Në territorin e bashkisë Krujë janë ndërtuar dhe po ndërtohen 3 zona të reja për zhvillim nga Qeveria Shqiptare në Krujë, Thumanë, Fushë Krujë dhe Bubq, ndërsa pjesa e mbetur prej 750 rastesh të miratuara, që janë banesa individuale të cilat do të rindërtohen nga vetë familjet në trojet e tyre, do të trajtohen me grantin e rindërtimit pas miratimit të lejës përkatëse të ndërtimit dhe demolimit të banesës së demtuar nga bashkia. **Ky proces ka vijuar pa ndërprerje nga momenti i lëvrimin të grantit për këtë program nga qeveria shqiptare nëpërmjet VKM Nr.145, datë 11.03.2022.***

Mënyra se si lëvrohet granti sipas strukturës përkatëse takuese të banimit përcaktohet qartë në legjislacionin e miratuar për procesin e programit të rindërtimit, por gjithashtu është i miratuar edhe me vendim të këshillit bashkiak ku është përpiluar edhe kontrata tip. Elementi kryesor për lëvrimin e grantit është miratimi i lejes së ndërtimit nga bashkia Krujë, pas aplikimit në sistemin e - lejet dhe brenda 10 ditësh nga zbardhja e lejes sipas parashikimeve të kontratës së grantit (bashkëlidhur neni 4, pika 4.2, A), drejtoria e financës pranë bashkisë është e detyruar të kryejë xhirimin e kështit të parë prej 60 % të vlerës së miratuar të grantit në llogarinë e përfituesit dhe pas lëvrimin të grantit njoftohet fillimi i punimeve.

Procesi i aplikimeve për lejen e ndërtimit nga banorët në bashkinë Krujë ka filluar në korrik 2022, pas njoftimit që morën nga bashkia dhe pas sqarimeve përkatëse për procedurat dhe

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

nuk ka patur ndërprerje, përveç 1 muaj e gjysëm në korrik 2022 për shkak të sulmeve kibernetike. Lejet e ndërimit marrin kohën e vet për miratim pasi lejet janë me dy faza (leje zhvillimi + leje ndërimit) dhe aktualisht janë miratuar 248 të tilla dhe 115 janë në proces verifikimi në sistem dhe priten përsëri aplikime të treja të rasteve të miratuara. Deri në janar të vitit 2023 janë lëvruar 130 grante dhe nga janari dhe në vijim 102 të tilla dhe ky proces, sikundër e përmendëm më lart, nuk mund të ketë ndërprerje për asnjë shkak për arsye se këto familje presin prej vitesh grantin, trajtohen me bonusin e qirasë i cili nuk mund të jepet më në rast se vonesat janë të pajustificuara, kanë kryer shpenzime për aplikimet përkatëse dhe me kontratat me firmat e ndërimit etj.

Përsa më sipër, jemi mjaft të keqardhur që ankimi i ardhur prek pikërisht një çështje mjaft sensitive për banorët e cila nuk duhet të përfshihet kurrsesi me politikën e ditës dhe hedhim poshtë çdo pretendim të tyre në lidhje me këtë denoncim dhe jemi të hapur për çdo hetim të

mundshëm administrativ në lidhje me faktet e renditura më lart”.

Në vijim të hetimit u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejten për tu shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë nga palët në proces.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ **për denoncimin nr. 373 ID vlerësoj se:**

Referuar pikës 3, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator parashikohet se **“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë”**...

Nga verifikimi i fakteve të administruara dhe pas shqyrtimit të provave në këtë çështje objekt shqyrtimi konstatohet se grantet e miratuara nëpërmjet aktit nënligjor nuk janë të periudhës 4 (katër) mujore para zgjedhjeve, por janë vënë në dispozicion përpara kësaj periudhe.

Në qoftë se bëjmë leximin “fjalë për fjalë” të nenit 91, pika 4të Kodit Zgjedhor, “deri në formimin e qeverisë së re” duket se legjislatori e kufizon “miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara” **vetëm për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend**. Sa më sipër, në mungesë të një dispozite ndaluese, nxjerrja e kësaj kategorie aktesh për zgjedhjet vendore, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Palët në këtë proces nuk mund të procedohen për miratimin e akteve, që në momentin

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

kur janë nxjerrë, nuk janë parashikuar nga Kodi Zgjedhor si shkelje administrative. Në këtë kuadër, miratimi i këtyre akteve prej të denoncuarit mbetet brenda parashikimeve të ligjit.

Megjithatë, edhe nëse do ndodheshim para rastit që dispozita e mësipërme do të zbatohet edhe për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, referuar kësaj dispozite ka raste përjashtimore, të cilat lejojnë nxjerrjen e këtyre akteve. Përjashtimet ligjore që parashikon dispozita **“kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë”** ose kur vjen për zbatim të **“detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar”** ose **“një vendim gjyqësor të formës së prerë”**. Pavarësisht se në momentin e nxjerrjes së aktit nuk kanë qenë aktive asnjë nga situatat e mësipërme, akti ka për qëllim të rregullojë pasojat të cilat rrjedhin nga **“gjenda e fatkeqësisë natyrore”** dhe është një procedurë në vazhdimësi të kësaj gjendjeje.

Në përfundim të hetimit administrativ si dhe të verifikimit të rrethanave dhe fakteve, vlerësoj se, veprimtaria e bashkisë Krujë nuk përfshihet në veprimtaritë e ndaluara sipas pikës 3, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Veprimtaria është një proces në vijimësi i cili ka të bëjë me emergjencat nga fatkeqësia natyrore dhe lëvrimi i granteve për familjet e demtuara nga termeti është realizuar me fonde publike sipas një plani buxhetor të miratuar, para periudhës 4 (katër) mujore të datës së zgjedhjeve. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ për denoncimin me **nr. 373 ID** pasi nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe as të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

5. Denoncimi i regjistruar me nr. 376 ID, ndaj kryetari i bashkisë Berat, z. Ervin Demo, për 1 (një) veprimtari publike të ndaluar për të cilën pretendohet si më poshtë vijon :

- Denoncimi nr. **376 ID**, marrë me shkresën nr. 171 prot., datë 2.5.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4539 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso, *“Z. Ervin Demo, kryetar i bashkisë Berat promovon shtrimin e asfaltit dhe përmirësimin e kushteve të qytetit në kohë fushate.”*

Më datë 4.5.2023, bashkisë Berat i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, për denoncimin e regjistruar me nr. 376 ID, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 6.5.2023, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Berat, ndër të tjera bën me dije se : *“Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar bashkia Berat ka kompetenca dhe detyrime ligjore në lidhje me mirëmbajtjen e të gjithë sipërfaqes administrative, që ndodhet nën juridiksionin e saj në bazë të ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të këtyre detyrave që përcakton ligji, bashkia Berat çdo vit realizon punime në mirëmbajtjen e e sipërfaqes së zonave që ndodhen nën juridiksionin e saj. Punimet për të cilat ju dhe ankesa e Partisë Demokratike i referoheni kanë filluar që prej vitit të kaluar dhe vazhduan deri në përfundimin e tyre, duke mos përfshirë aspak ngjyrimet elektorale, apo afate sikundër pretendohet nga ankesa.*

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

Asfaltimet, në zonat brenda rajoneve dhe Njësive Administrative janë kryer, nga bashkia Berat, si çdo vit sipas nevojave që ato paraqesin, ato kanë filluar në muajt e fundit të vitit 2022 dhe kanë vazhduar sipas nevojave, pa pasuar asnjë qellim tjetër, apo të jenë kryer për ndonjë shkak tjetër, të supozuar, përveçse në mirëmbajtjen e sipërfaqjes së territorit administrativ të Bashkisë Berat në kuadër dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi“.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023 ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e Bashkisë Berat.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se :

Në lidhje me denoncimin konstatojmë se bëhet fjalë për një aktiviteti në përmbushje të detyrave funksionale të z. Ervin Demo, në cilësinë e kryetarit aktual të bashkisë Berat.

Referuar nenit 3, pika 1.1 shkronja “a”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “ku parashikohet se “1. “veprimtari të ndaluara për tu promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, **për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:**

- a) **mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut.**

Në mënyrë që të konstatohet shkelja duhet të provohet :

1. Fondet duhet të jenë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.
2. Promovimi nëpërmjet, publikimit, publicitetit, shërndarjes apo çdo lloj veprimtarie të ngjashme me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut.

Gjatë hetimit, nuk u arrit të provohej asnjëra nga kushtet që kërkon ligji, pasi veprimtaria nuk ka qenë publike, nuk është publikuar në faqet zyrtare të bashkisë Berat dhe së fundmi, fondet për kryerjen e rrugës, objekt denoncimi janë vendosur në dispozicion para periudhës së parashikuar si të ndaluar nga ligji.

Referuar nenit 92, pika 1 Kodit Zgjedhor parashikon detyrimin e institucioneve publike për të raportuar në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik”, u vlerësua se veprimtaria objekt denoncimi nuk është veprimtari publike dhe nuk ka pasur detyrimin për raportim.

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

Për sa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe të nenit 3 dhe 4, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator dhe për këto arsye vlerësohet se duhet të pushohet hetimi administrativ për z. Ervin Demo, kryetar dhe kandidat i bashkisë Berat.

6. Denoncimi regjistruar me nr. 377 ID, ndaj z. Blendi Gonxhe drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon :

- **Denoncim nr. 377 ID**, marrë me shkresën nr. 167 prot., datë 2.5.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4542 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso: *“Shpërdorim i taksave të qytetarëve për fushatë elektorale, nga ana e z. Blendi Gonxhe”*.

Prova link :

<https://www.facebook.com/retro.albania/videos/130433530014503/%20?mibextid=j8LeHn>

Më datë 4.5.2023, z. Ivi Kaso i është kërkuar informacion plotësues në lidhje me denoncimin e regjistruar me nr. 377 ID, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i janë përgjigjur kërkesës tonë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023 ora 12:00, ku u ftuar pala denoncuese por nuk u paraqit.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ vlerësoj se :

Pasi u shqyrtuan pamjet filmike, provat dhe faktet, vlerësoj se veprimtaria e kryer nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Nga hetimi i kryer rezulton që veprimtaria e denoncuar *“Retro Tirana”*, me vend zhvillimi në sheshin *“Skënderbej”*, datë zhvillimi 29.4.2023, është raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, nga DPSHTRR datë 19.4.2023, brenda afatit ligjor 5 (pesë) ditor të parashikuar në ligj. Nga këqyrja e materialit, nuk rezulton që në këtë aktivitet të ketë shpërdorim të fondeve publike, por përbën një veprimtari publike në kuadër të funksionalitetit të institucionit.

Për sa më sipër, vlerësojmë se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Blendi Gonxhe, nuk përbën shkelje të neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe të të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

7. Denoncimi i regjistruar me nr. 378 ID ndaj bashkisë Pukë, subjekti zgjedhor z.Gjon Gjonaj për 1 (një) veprimtari, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi me nr. 378 ID**, marrë me shkresën nr. 161 prot., datë 2.5.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4541 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso, *"Promovim i përmirësimit infrastrukturor në fshatin Gojan, bashkia Pukë. Z. Gjonaj është i dënuar në Itali për veprë penale dhe i kallëzuar në SPAK në vitin 2021 nga Partia Demokratike."*

Më datë 4.5.2023 nëpërmjet postës elektronike e-mail i është kërkuar z. Ivi Kaso informacion shtesë për të plotësuar denoncimin, në mënyrë të tillë që KQZ të vijojë me hetimin administrativ.

Në vijim të hetimit u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan pala denoncuese por nuk u paraqit në seancë.

Nga verifikimi i fakteve të administruara dhe pas shqyrtimit të provave dhe materialit filmik të administruar, nuk u arrit të provohej aktiviteti, tematika e veprimtarisë dhe as pjesëmarrësit. Në mungesë të informacionit të nevojshëm, pavarësisht kërkesës për plotësim të dhënash të denoncimit, vlerësoj se faktet e administruara për objektin rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për vërtetimin e shkeljes në parashikimet e nenit 91, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin nr. 378 ID.

8. Denoncimi regjistruar me nr. 382 ID, ndaj z. Nikoll Doda, Oficer i Patrullës së Përgjithshme në Komisaratin e Policisë Kurbin, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon :

- **Denoncimi nr. 382 ID**, marrë me shkresën nr. 152 prot., datë 27.4.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4555 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso, *"Punonjës të Policisë së Shtetit janë përfshirë në fushatën elektorale të kandidatit të Partisë Socialiste për bashkinë Lezhë z. Pjerin Ndreu. Në foto bashkangjitur ndodhet z. Nikoll Doda (me xhup të kuq) i cili është polic në Komisaratin e Lezhë, i jati i tij dhe vëllai polic, janë përfshirë në takimet elektorale."*

Në datë 4.5.2023, bashkisë Lezhë i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 5.5.2023 ka sqaruar se *"Nga verifikimet dhe këqyrja e fotos së dërguar, rezulton se personi në foto ka ngjashmëri me punonjësin e policisë z. Nikoll Anton Doda, aktualisht me detyrë Oficer i Patrullës së Përgjithshme në Komisaratin e Policisë Kurbin, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Gjatë intervistimit të punonjësit të policisë z. Nikoll Doda, ai deklaroi se personi në foto nuk jam unë po është vëllai im, i cili quhet Julian Anton Doda, i cili nuk është punonjës policie, por ka qenë punonjës i Forcave të Armatosura në Marinën Shëngjin dhe është larguar nga puna për arsye shëndetësore, në dhjetor të vitit 2022. Nga verifikimi i fotos nuk rezulton që të jetë në foto*

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

shtetasi Anton Prëng Doda, aktualisht oficer i patrullës së përgjithshme në Postën e Policisë Shëngjin në Komisarlatin e Policisë Lezhë në DVP Lezhë. Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit kanë qënë dhe janë të angazhuara maksimalisht për respektimin e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga bashkia Lezhë.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me nr. **382 ID**, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se :

Referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se **“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”**. Po ky nen parashikon se “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe **çdo burim njerëzor i institucionit**.

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator, në nenin 3 pika 1.3, shkronja “ç”, parashikon **“përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore ..., ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim**.

Gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohet se personi i cili ndodhet në foton e administruar si provë në këtë denoncim, është punonjës i administratës shtetërore. Përsa më sipër, vlerësoj se faktet e administruara për objektin rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për vërtetimin e shkeljes në parashikimet e nenit 91, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

9. Denoncimi i regjistruar me nr. 384 ID ndaj bashkisë Tiranë, për të cilat pretendohet si vijon :

- **Denoncimi nr. 384 ID**, marrë me shkresën nr. 155 prot., datë 27.4.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4559 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso, **“Në datën 25 Prill kryetari i**

bashkisë z. Erion Veliaj gjatë takimit me qëllim fushate me bizneset

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

përgjatë rrugës pranë maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", ka hasur kundërshtimin e pronarit të një biznesi. Të nesërmen policia bashkiake ka marrë masën e gjobës për këtë biznes, si hakmarrje ndaj sjelljes së pronarit".

Më datë 4.5.2023, Bashkisë Tiranë i është kërkuar informacion, nëpërmjet adresës elektronike dhe më datë 5.5.2023, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Tiranë, ndër të tjera bën me dije se: *"Referuar Ligjit 89/2022 datë 22.12.2022 "Për Policinë Bashkiake ", si dhe VKB – së 156 datë 21.12.2018, Shërbimet e Policisë Bashkiake gjatë kontrollit të territorit, në datë 25 Prill, në Bulevardin "Zogu i Parë", Njësia Administrative Nr. 9, kanë konstatuar se subjekti Drita Ruçi, me NIPT : M11619012N, kishte zënë hapsirën publike me çadër, pa leje përkatëse nga bashkia Tiranë. Për sa më sipër, ndaj subjektit në fjalë është marrë masë administrative dhe është liruar hapsira e zënë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Në lidhje me pretendimet e subjektit politik, ju informojmë se pas verifikimeve të bëra ka rezultuar se Kryetari i bashkisë Tiranë nuk ka qenë prezent me datë 25 Prill në Bulevardin "Zogu i Parë".*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga Bashkia Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, për denoncimin **nr. 384 ID**, vlerësoj se :

Referuar nenit 3, pika 1, nën pika 1.3, shkronja "dh", të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ndër veprimtaritë e ndaluara, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë kontrollet dhe verifikimet e bizneseve tregtare dhe operatorëve në kundërshtim me procedurat ligjore dhe veprimtarinë institucionale. Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator ka dalë në zbatim të nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**. Vendimi nuk ka për qëllim të ndalojë funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe as të ndalojë procedura normale administrative që kryejnë këto institucione.

Në mënyrë që të konstatohet shkelja e dispozitave të vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, përvec kërkesave që parashikon neni 3, pika 1.1, shkronja "dh", duhet njëkohësisht të vërtetohet qëllimi zgjedhor që ka pasur institucioni në vendosjen e gjobës administrative, si kërkesë e pikës 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Kështu, në mënyrë që të konstatohet shkelja e këtij neni duhet të provohohen në mënyrë komulative të gjitha elementët e mëposhtëm :

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

1. Kontrollat dhe verifikimet e bizneseve tregtare dhe operatorëve **në kundërshtim me procedurat ligjore dhe veprimtarinë institucionale.**
2. Masa e kundërligjshme të jetë vënë për qëllime zgjedhore.

Mbështetur nga provat, faktet dhe pretendimet e disponuara, konstatojmë se nuk provohet se kontrolli i biznesit tregëtar të jetë kryer në kundërshtim me procedurën ligjore. Vetëm fakti që një masë administrative jepet gjatë periudhës zgjedhore nuk vërteton “qëllimin zgjedhor” si kërkesë absolutisht të domosdoshme për vërtetimin e shkeljes. Në këto kushte, vlerësoj se veprimtaria e denoncuar nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator dhe për këto arsye duhet të pushohet hetimi administrativ për denoncimin nr.384 ID.

10. Denoncimi regjistruar me nr. 353 ID ndaj Komitetit të Investimeve Strategjike, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon :

- Denoncimi nr. **353 ID**, marrë me shkresën nr. 165 prot., datë 2.5.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4540 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso, “Në datën 1.2.2023, Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) miratoi me anë të vendimit të tij nr. 29/4, miratoi statusin investim/investor strategjik për projektin e investimit “Green House Korça Resort”.

-

Bashkëlidhur vendimi.

Më datë 5.5.2023 Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Në vijim të hetimit administrativ, u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12.00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për tu shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, në të cilën ishte i pranishëm përfaqësuesi i Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve AIDA dhe parashtrori shpjegimet e tij të cilat i depozitoi edhe me shkrim si vijon:

Në lidhje me denoncimin përfaqësuesi i Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka pretenduar se: “Vendimi i KQZ nr. 9 datë 24.12.2020, të cilit i referohet denoncuesi, nuk gjen zbatim në rastin konkret. Para së gjithash sjellim në vëmendjen tuaj se referuar legjislacionit në fuqi dhe konkretisht ligjit nr. 55/2015 “Për investimet startegjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, AIDA luan rolin e sekretariatit teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike. Norma nënligjore në fjalë nuk ndalon “shprehimisht miratimin e investimeve strategjike” por “mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi”. Në këtë aspekt, miratimi i vendimit nr. 29/4 datë 1.2.2023 nga Komiteti i Investimeve Strategjike KIS, të cilit i referohet denoncuesi, është bërë

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

në respektim të procedurave administrative dhe afateve të posaçme të mirëpërcaktuara në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në RSH”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në dhe për zbatim të tij. Theksohet se normat ligjore e nënligjore, që rregullojnë fushën e investimeve strategjike, parashikojnë rregulla të qarta dhe specifike në lidhje me procedurën administrative të pranimit, vlerësimit dhe shqyrtimit të një aplikimi për përfitimin e statusit investim/investitor strategjik. Në këtë aspekt, këto norma parashikojnë afate të caktuara lidhur me paraqitjen e aplikimeve/kërkesave nga subjektet e interesuara si dhe me shqyrtimin e marrjen e vendimit përkatës për pranimin ose jo të këtyre kërkesave. Komiteti i Investimeve Strategjike, në rastin konkret, ka marrë një vendim administrative në respektim të parashikimeve ligjore, sipas procedurave normale ligjore që normojnë detyrimet dhe funksionet e veta ligjore. Marrja vendimi ka ardhur si pasojë e një aplikimi dhe kjo është në përputhje të plotë me funksionimin normal të organit. Por në asnjë rast, marrja e këtij vendimi nuk është shoqëruar me asnjë lloj promovimi, publiciteti, apo aktiviteti publik. Edhe në rast se vendimi nr. 9 i KQZ i sipërcituar të kishte vlere ligjore në rastin konkret, kjo nuk nënkupton “Pengim, ndalim ose mosushtrim i funksioneve të veta” si institucion – pra nuk nënkuptohet mos shqyrtim i aplikimeve/kërkesave për status strategjik dhe marrje e vendimeve, sepse kështu institucioni do të vepronte në kundërshtim me ligjin e vet organik. Dhe vendimi i KQZ nr. 9, datë 24.12.2020, nuk flet për mosushtrim detyrash funksionale, por për veprimtari të ndaluara për t’u promovuar. Po në këtë linjë është edhe shkresa e datës 11.1.2023, me nr. 138 prot., e KQZ, në pikën 2 të të cilit, theksohet se “një veprimtari është publike kur ajo do të pasqyrohet sipas rastit në radio, televizion, në shtyp, etj.” Në këtë aspekt vendimi i KIS nuk është mbështetur dhe nuk është promovuar në publik, radio, tv etj, në mënyrë që të konsiderohet si veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe as si veprimtari e ndaluar për tu promovuar, në kuptim të nenit 1, pika 1.1 të vendimit të KQZ nr. 9k datë 24.12.2020. Për këtë arsye AIDA nuk ka pasur as detyrimin për të njoftuar KQZ sipas përcaktimeve të vendimit nr. 9. Pavarësisht sa më sipër, një vendim i KIS në asnjë rast nuk parashikon mbështetje apriori për subjektet përfitues, por vetëm miraton në parim. Janë një sërë procesesh të tjera administrative të cilat përcaktojnë, vendosin dhe miratojnë përfundimisht të drejta specifike për subjektet e interesuar, që kërkojnë të përfitojnë nga statusi investim/investitor strategjik. Pikërisht për këtë shkak, vendimi nr. 29/4 datë 1.2.2023 i KIS parashikon se: vendimi i KIS, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në RSH, duke qenë se **miraton në parim realizimin** e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.”

Në përfundim të hetimit administrativ rezultoj se, Komiteti i Investimeve Strategjike ka miratuar vendimin nr. 29/4, datë 1.2.2023, ” Për miratimin e statusit investim/investitor strategjik procedurë e asistuar për projektin e investimit “Green House Korca Resort”, me subjekt “Investment and Development Albania ”.

Referuar nenit 3, pika 1.1, shkronja “ç” parashikon se veprimtari të ndaluara për tu promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

cilat janë vënë **rishtazi apo posaçërisht në dispozicion**, apo janë transferuar **fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar**, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë ndër të tjera: ç) **mbështetjen** dhe **promovimin** e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi.

Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator ka dalë në zbatim të nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe çdo dispozitë e tij duhet të lexohet në kuadër të kërkesave dhe qëllimeve që kanë këto nene. Qëllimi i dispozitës është që të garantojë paanshmëri dhe trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për **mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime zgjedhore**. Vendimi nuk ka për qëllim të ndalojë funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe as të ndalojë procedura normale administrative që kryejnë këto institucione.

Në mënyrë që të konstatohet shkelja e dispozitave të vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, përvec kërkesave që parashikon neni 3, pika 1.1, shkronja "ç", duhet njëkohësisht të vërtetohet qëllimi zgjedhor që ka pasur institucioni në nxjerrjen e një akti të tillë, si kërkesë e pikës 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Vetëm fakti që një akt nxirret gjatë periudhës zgjedhore nuk vërteton "qëllimin zgjedhor" si kërkesë absolutisht të domosdoshme për vërtetimin e shkeljes.

Kështu, në mënyrë që të konstatohet shkelja e këtij nenit duhet të provohohen në mënyrë kumulative të gjitha elementët e mëposhtëm:

- 1- Fondet duhet të jenë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.
- 2- Promovimi ose mbështetja e projektit (mbështetje monetare e projektit) duhet të bëhet nëpërmjet publikimit, publicitetit, shpërndarjes apo çdo lloj veprimtarie të ngjashme me qëllim njohjen e gjerë tek publiku.
- 3- Përdorimin ose të vënien në dispozicion të burimeve publike të një organi publik, me qëllim mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të *koalicioneve në zgjedhje*.

Gjatë hetimit administrimit Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk arriti të vërtetonte qëllimin zgjedhor në miratimin e një vendimi, i cili rezultoi të jetë bërë në respektim të procedurave administrative dhe afateve të posaçme të mirëpërcaktuara në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Përsa më sipër, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrative pasi në këtë rast institucioni publik ka kryer detyrat e tij funksionale dhe nuk jemi para një veprimtarie të ndaluar në kuptim të nenit 3 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

11. Denoncimi regjistruar me nr. 389 ID, ndaj bashkisë Fier, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon :

- **Denoncimi nr. 389 ID**, marrë me shkresën nr. 168 prot., datë 2.5.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 4543 prot., datë 3.5.2023, nga z. Ivi Kaso, *“Punonjësit e bashkisë Fier kushtëzojnë shërbimin kundrejt qytetarëve të cilët paraqiten pranë këtij institucioni publik dhe nuk ofrojnë shërbim ndaj tyre, derisa të ketë konfirmuar statusin "pëlqyer" (like), për veprimtarinë e publikuar nga kryetari i bashkisë.”*

Prova link :

<https://ëëë.facebook.com/joqvideos/videos/234054629215456/?mibextid=cr9u03>

Më datë 4.5.2023, bashkisë Fier i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, por nuk i është përgjigjur kërkesës tonë.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 8.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për tu shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk pati të përfaqësuar nga ana e bashkisë Fier.

Nga verifikimi i fakteve të administruara dhe pas shqyrtimit të provave dhe materialit filmik të administruar, nuk u arrit të provohej shkelja e pretenduar nga denoncuesi. Nëpërmjet materialit, nuk mund të provohet fakti që punonjësja e bashkisë ka shpërdoruar fondet publike, por rezulton vetëm një pamje filmike pa zë, nëpërmjet të cilës punonjësi përdor rrjetet sociale. Për sa më sipër, rezulton se faktet e administruara për objektin rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për vërtetimin e shkeljes në parashikimet e nenit 91, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në këto kushte vendos pushimin e hetimit administrativ.

12. Denoncimi regjistruar me nr. 354 ID, ndaj Bashkisë Sarandë, e cila ka lejuar zhvillimin e një aktiviteti elektoral për subjektin zgjedhor z. Oltion Çaçi, në ambiente të një institucioni publik, denoncim, i cili është regjistruar me nr. 354 ID.

- Denoncimi nr. **354 ID**, i administruar nga raportimi i monitorimit me nr. 28724454 të datës 23.4.2023, ku pretendohet se: *“Është zhvilluar fushatë zgjedhore në një institucion publik - kandidati i Partisë Socialiste të Shqipërisë z. Oltion Çaçi ka zhvilluar një takim elektoral në ambientet e jashtme të kopshtit nr. 1, me adresë “Rruga Onhezmi” Sarandë, më datë 23.04.2023 Sarandë”.*

Më datë 26.4.2023, nëpërmjet postës elektronike, i është kërkuar informacion bashkisë Sarandë dhe subjektit zgjedhor, në lidhje me denoncimin e administruar.

Më datë 2.5.2023, **bashkia Sarandë** ka informuar se “Kopshti nr. 1, me VKM nr. 411, datë 09.08.2005, ka kaluar në inventar të pronave të bashkisë Sarandë me sipërfaqe prej 1050 m², nga e cila 450 m² është ndërtesë. Aktiviteti i zhvilluar për të cilin bën fjalë raporti i monitorimit, është jashtë sipërfaqes të mësipërme, e konkretisht në terren të cilat janë publike, e përdorur si ambiente relaksuese për banorët e lagjes”.

Në vijim të hetimit administrativ, janë njoftuar palët për zhvillimin e seancës publike, të mbajtur më datë 5.5.2023, por nuk janë paraqitur në seancë asnjë nga palët.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor “Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e**

organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.” Pretendohet se për kryerjen e aktivitetit elektoral të z. **Oltion Çaçi** ka përdorur burime publike, siç janë ambientet rrethuese të Kopshtit nr. 1, Sarandë, në funksion të fushatës zgjedhore. Nga hetimi rezultoi se, ambientet ku është kryer aktiviteti elektoral, është ambient publik dhe jo ambient rrethues i Kopshtit nr. 1.

Kopshti nr. 1 ndodhet në katin e parë të një blloku banimi dhe hapësira në pronësi të kopshtit, nuk është qartësisht e ndarë nga ambientet e tjera publike. Hapësira ku është kryer aktiviteti elektoral, pavarësisht se e kufizuar me mur rrethues, nuk është pjesë e institucionit publik, por ambient publik i përbashkët i aksesuesueshëm lirisht nga kushdo. Për sa më sipër vlerësoj se denoncimi me nr. 354 ID, për bashkinë Sarandë dhe subjektin zgjedhor z. Oltion Çaçi, nuk përmban elementë për konstatimin e shkeljes së nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

13. Denoncimi regjistruar me nr. 255 ID, ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë, Njësia 11, për publikimin e postimeve në faqen e tyre facebook të cilat tregojnë përdorimin e burimeve publike, denoncim i regjistruar me **nr. 255 ID.**

- Denoncimi **nr. 255 ID**, më kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 106 prot., datë 30.3.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 2341 prot., datë 31.3.2023 ku pretendohet se “Në datën 12.03.2023, përfaqësues të Partisë Socialiste të Shqipërisë, kanë publikuar në rrjetet sociale një status dhe foto me punëmarrës të bashkisë Tiranë, Drejtorisë Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, që me rastin e festave të 7-8 Marsit, kanë promovuar punën

- e z. Erion Veliajt si kandidati i duhur për kryetar të bashkisë Tiranë, veprim ky që tregon qartazi përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe aktivitete për qëllime zgjedhore, në kundërshtim me nenin 3, pika 1.3, shkronja ç dhe nenin 6, pika 3 të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Pas verifikimit të kryer, u vlerësua se postimet në **llogaritë personale** në rrjetin social “facebook” të subjekteve zgjedhore, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Subjektet zgjedhore kanë karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit.

Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale nga ana e subjekteve zgjedhore. Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përligjura.

Postimet në llogaritë personale në rrjetin social “facebook” të subjektit zgjedhor, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore sic janë liria për tu shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për denoncimin me **nr. 255 ID**.

14. Denoncimet, regjistruar me nr. 252 ID, 253 ID, 254 ID, 286 ID, ndaj Zj. Eglantina Zere, Drejtor i “Tirana Parking” njëkohësisht edhe kryetar i “Partisë Socialiste së Shqipërisë”, për Njësinë nr. 11, ka kryer veprimtari të cilat tregojnë përdorimin e burimeve publike, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor, veprimtari të regjistruara me nr. 252, 253, 254, 286 ID.

- **Denoncimi nr. 252 ID**, dërguar me shkresën nr. 105 prot., datë 30.03.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 2343 prot., datë 31.03.2023, nga deputeti zj. Albana Vokshi e cila pretendon se: *“Në datën 07.03.2023, kryetarja e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, njësia 11 ka publikuar në rrjetet sociale (FB) të PS Njësia 11 një status dhe foto me të gjitha stafet pedagogjike në njësinë nr.11, veprim ky që tregon qartazi përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe aktivitete për qëllime zgjedhore.*
- **Denoncimi nr. 253 ID** dërguar me shkresën nr. 107 prot., datë 30.3.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 2340 prot., datë 31.3.2023, nga deputeti zj. Albana Vokshi e cila pretendon

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

se: "Në datën 8.3.2023, përfaqësues të "Partisë Socialiste të Shqipërisë", kanë publikuar në rrjetet sociale (FB) një status dhe foto në ambientet e zyrave të Ambulancës nr.7, Kodër Kamëz, njësia administrative 11, Tiranë, takimin e mbajtur me strukturat e këtij institucioni publik, veprim ky që tregon qartazi përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe aktivitete për qëllime zgjedhore".

- **Denoncimi nr. 254 ID** Denoncimi i dërguar me shkresën nr. 105/1 prot., datë 30.3.2023, i administruar pranë nesh me shkresën 2342 prot., datë 31.3.2023 dhe i regjistruar me nr. 254 ID, ku pretendohet se: "Në datën 7.3.2023, kryetarja e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" për njësinë nr.11, zj. Eglantina Zere kanë publikuar në rrjetet sociale (FB) një status dhe foto me drejtorin e Shkollës z. Ahmet Gashi dhe nxënësit e shkollës, veprim ky që tregon qartazi tregon përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe aktivitete për qëllime zgjedhore.
- **Denoncimi nr. 286 ID**, administruar nga portali i denoncimeve, i identifikuar me numër unik. 7817 nga deputeti zj. Albana Vokshi e cila pretendon se: "Në datat 25.3.2023, 31.3.2023 dhe 1.4.2023, Partia Socialiste të Shqipërisë, Njësia 11, ka publikuar në rrjetet sociale (FB) një status dhe foto me inagurimin e një këndi investim i Bashkisë Tiranë, veprim ky që tregon qartazi përdorimin në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe aktivitete për qëllime zgjedhore. Theksojmë faktin që drejtuesja e Partisë Socialiste njësia 11, njëkohësisht Drejtor i Përgjithshëm i Tirana Parking, përgjatë çdo ditë të javës, edhe gjatë orarit të punës kryen veprimtari politike në funksion të fushatës zgjedhore për kryetarin e bashkisë Tiranë".

Më datë 13.4.2023, nëpërmjet postës elektronike, i është kërkuar informacion Tirana Parking dhe subjektit zgjedhor, në lidhje me denoncimet e administruara me nr. 252,253,254,286 ID dhe më datë 21.4.2023, personi përgjegjës pranë Tirana Parking, ka sqaruar se:

1. "Së pari, të **gjitha denoncimet bazohen në postimet e realizuara në rrjetin social Facebook me emër "Partia Socialiste Njesia 11", duke pretenduar dhe akuzuar pa asnjë fakt që kjo faqe administrohet nga ana e titullarit të "Tirana Parking".** Deklarojmë se pretendimet e palës denoncuse janë të pabazuara në fakte apo në ligj, përvec aludimit nuk është depozituar asnjë provë që vërteton se postimet në rrjetin FB Partia Socialiste Njësia 11 janë bërë nga ana e titullarit të Institucionit Tirana Parking Znj.Eglantina Zere, aq më tepër gjatë orarit zyrtar.
2. **Së dyti**, Në lidhje me pretendimin për përdorimin e detyruar të administratës për veprimtari politike, sqarojme se: Asnjë nga takimet e referuara në denoncimet e paraqitura nga ana juaj me përmbajtje urim për festat e 7-8 Marsit, nuk ka shkelje të nenit 3 pika 1.3/ç e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Aktivitetet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime zgjedhore, nuk janë mediatizuar si dhe nuk ju është ofruar apo premtuar përfitime nëpunësve publikë si dhe nuk është ushtruar presion ndaj tyre për qëllime zgjedhore. Vetëm në rast se do ishte përmbushur ndonjëri prej këtyre kritereve do ishim në kushtet e veprimtarisë së ndaluar parashikuar nga

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

vendimi i Komisionit Rregullator. Gjithashtu bazuar në nenin 6, pika 3 të po këtij vendimi përcaktohet se: “Punonjësit e administratës Shtetërore gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda institucioneve shtetërore i ndalohet cdo lloj pjesmarjeje në veprimtari me karakter Politik...”. Duke interpretuar këtë pike, rezulton se në asnjë nga takimet e denoncuara nuk ka elemente të veprimtarisë me karakter politik apo zgjedhor. Për këtë arsye pjesëmarrja e titullarit të “Tirana Parking” në takime të tilla me përmbajtje tërësisht jashtë politikës apo fushatës zgjedhore nuk bie ndesh me ndalimet ligjore.

3. **Së treti**, Në lidhje me akuzën që Znj. Eglantina Zere, drejtuese e Partisë Socialiste, Njesia 11, njëkohësisht dhe Drejtor i Përgjithshëm i “Tirana Parking” ka kryer veprimtari politike gjatë orarit të punës në funksion të fushatës ju informojme se: Detyrën e saj si drejtuese e Tirana Parking e ka kryer me seriozitet dhe përgjegjshmëri duke mos cënuar asnjë parashikim ligjor në fuqi. Thënë kjo, në asnjë moment nuk ka shfrytëzuar pozicionin e saj për qëllime politike/zgjedhore duke respektuar legjislacionin i cili parashikon orarin zyrtar të përcaktuar në Vendimin Nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe detyrat funksionale të parashikuara në VKB Nr.48, datë 11.11.2015 “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë dhe pa pagesë”. Do të donim t’iu sillnim në vëmendje, se në përmbushje të detyrave të zj. Eglantina Zere si drejtuese e një strukture shumë të rëndësishme për menaxhimin e parkimit në qytet, dhe në kushtet kur numri i mjeteve të transportit në Tiranë sa vjen dhe rritet lind nevoja dhe përgjegjësia që të jetë shumicën e kohës prezente në takime me përgjegjës të strukturave të tjera, biznese, apo entitete që kryejnë veprimtari brenda qytetit të Tiranës dhe kanë nevojë për zgjidhjen e problematikave të parkimit.

Nga ana tjetër, angazhimi i saj politik është konform përcaktimeve të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga Kushtetuta e në vijim për bindjet politike, përfshirë këtu dhe vendimin e Këshillit të Ministrave “Për marjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore për vitin 2023” konkretisht pika 3 dhe 4, ku përcaktohet se: 3. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës së procesit zgjedhor, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor.

4. Punonjësi i administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje. Gjithashtu i njëjti parashikim ligjor është miratuar në nenin 6, pika 1 të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020. Në përfundim, pretendimet e parashtruara në denoncimet e cituara më lartë janë të

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

pabazuara ligjërisht. Veprimtaria e zj. Eglantina Zere, titullare e institucionit "Tirana Parking" në cilësinë e nëpunësit publik është në zbatim të plotë të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë dhe mbikëqyrin proceset zgjedhore".

Në vijim të hetimit administrativ, janë thirrur njoftuar palët për zhvillimin e seancë publike, të mbajtur më datë 3.5.2023, ora 12:00, por pala e denoncuar, për arsye objektive ka kërkuar shtyrjen e seancës publike.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se:

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor **"Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia".** Më tej, pika 2 e këtij neni parashikon se **"2 "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të "burimeve njerëzore" kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.**

Denoncuesi pretendon se zj. Zere, ka përdorur burime publike pasi, ajo është identifikuar se ka bërë disa foto me punonjës të institucioneve në varësi të bashkisë Tiranë, dhe këto foto ishin shpërndarë nga Facebook i "Partisë Socialiste, Njësia 11". Megjithatë, neni 91, pika 2 e Kodit Zgjedhor kërkon plotësimin e disa kushteve, për të konstatuar shkeljen.

"Përdorim i detyruar", "premtimi ose ofrimi i përfitimeve" dhe kryerjen e veprimtarisë "brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore". Gjatë hetimit nuk u arrit të provohej administrativisht asnjë nga pretendimet e denoncuesit.

Denoncuesi nuk depozitoi prova të mjaftueshme për të konstatuar **"përdorimin e detyruar"** të administratës apo **"premtimi ose ofrimi i përfitimeve"** për punonjësit.

Zj. Zere, referuar dhe shkresës së administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në përmbushje të detyrave të veta funksionale, konform dispozitave ligjore, është e detyruar t'ju japë zgjidhje situatave me të cilat përballlet. Gjithashtu vlerësojmë se, nuk mund të provohet lidhja e dejtëpërdrejtë midis postimeve në facebook të një subjekti zgjedhor me veprimtarinë e zj. Zere.

Pas verifikimit të kryer, u vlerësua se postimet në **llogaritë personale** në rrjetin social

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

“facebook” të subjekteve zgjedhore, nuk mund të përbëjnë prova të mjaftueshme për të provuar lidhjen midis postimit dhe përdorimit të fondeve publike. Subjektet zgjedhore kanë karakter dhe natyrë politike dhe si i tillë mund të postojë në faqen personale mesazhe politike, promovim të nismave politike, festim të arritjeve politike apo çdo lloj materiali tjetër politik, për tërheqjen e elektoratit. Theksohet se legjislacioni në fuqi, referuar këtu ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk parashikojnë asnjë rregullim ligjor të shprehur mbi administrimin e mediave sociale nga ana e subjekteve zgjedhore. Në kushtet kur nuk është e qartë apo e rregulluar shprehimisht nga ligji kufiri i përdorimit të këtyre mjeteve të komunikimit, pretendimet e palës denoncuese janë të pabazuara dhe jo të përligjura.

Postimet në llogaritë personale në rrjetin social “facebook” të subjektit zgjedhor, dalin jashtë fushës së zbatimit dhe objekti të rregullimit të Kodit Zgjedhor dhe akteve normative në fuqi dhe si të tilla nuk mund të trajtohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Parashikimi i ndalimeve për sa i përket këtyre postimeve me natyrë politike interferon në liritë themelore sic janë liria për tu shprehur si dhe liritë dhe të drejtat politike. Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet procedimi administrativ për denoncimin me **nr. 252, 253, 254 dhe 286 ID** pasi nuk u arrit të provohej shkelja e nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe as të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

15. Denoncimi regjistruar me nr. 327 ID, ndaj Ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, ka kryer 1 (një) veprimtari publike **të regjistruara me nr. 327 ID**, për të cilat pretendohet si vijon:

- Denoncimi **nr. 327 ID**, më kërkues z. Flamur Noka, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 120 prot., datë 17.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3914 prot., datë 18.4.2023 ku pretendohet se: *“Më datë 02.03.2023, në media është publikuar foto e Ministrit z. Niko Peleshi dhe artikulli respektiv për promovimin e rritjes së pagave me 7% të ushtarakëve dhe rekrutimi i Forcave të Armatosura, veprim ky në kundërshtim me dispozitat ligjore”.*

Nëpërmjet e-mail të datës 26.4.2023 me lëndë “Kërkesë për informacion” i është kërkuar personit përgjegjës pranë Ministrit të Mbrojtjes, informacion sqarues në lidhje me denoncimin regjistruar me **nr. 327 ID**, rezulton që nuk i janë përgjigjur kërkesës.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi se: Denoncuesi pretendon se Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi me promovimin e rritjes së pagave me 7% të ushtarakëve, ka kryer veprimtari e cila ndalohet nga ligji. Megjithatë, neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 3, i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator ka një listë të mbyllur veprimtarish të cilat konsiderohen të ndaluara për t’u zhvilluar. Promovimi i rritjes së pagave, nuk konsiderohet veprimtari e ndaluar nga Kodi Zgjedhor dhe

as nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Në mungesë të një dispozite ndaluese, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se veprimtaria e z. Peleshi është brenda kuadrit ligjor zgjedhor.

Përsa më sipër, nga tërësia e provave dhe fakteve të administruara, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ ndaj Ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi pasi nuk u konstatua shkelja e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe e nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

i. Denoncimi regjistruar me nr. 329 ID, ndaj zj. Belinda Balluku Zëvendëskryeministër, dhe bashkisë Dibër, ka kryer 1 (një) veprimtari publike e regjistruar me nr. 329 ID, për të cilën pretendohet se:

- **Denoncimi nr. 329 ID** me kërkues z. Flamur Noka, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 125 prot., datë 17.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3916 prot., datë 18.4.2023 ku pretendohet se: *"Mbështetur në denoncimin e kryer në rrjetin social facebook të z. Premtim Kryemadhi, janë publikuar disa foto në të cilat shfaqet Zvendëskryeministëri z. Belinda Balluku dhe Drejtuesi i Zyrës Arsimore Vendore Dibër në një ceremoni ndarjesh certifikatash për stafin e Zyrës Vendore Arsimore Dibër"*.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me nr. **329 ID**, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se :

Rezultoi se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Belinda Balluku dhe bashkisë Dibër, është i njëjtë me denoncimin nr. 224 ID. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është shprehur me **vendimin nr. 387, më datë 19.4.2023** "Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 151, 152, 153, 165, 166, 177, 216, 217, 224, 231, 232, 234, 235, 236, 245, 257, 263, 268, 271, 272, 277, 278, 279 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj personave përgjegjës, për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023". Në këto kushte të ndodhur përpara një denoncimi të gjykuar më parë (res iudicata) vlerohet se duhet pushuar çështja objekt gjykimi.

ii. Denoncimi regjistruar me nr. 332 ID, ndaj Z. Bujar Dema, ka kryer 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet se:

- **Denoncimi nr. 332 ID** më kërkues z. Flamur Noka, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 127 prot., datë 17.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror

të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3919 prot., datë 18.4.2023 ku pretendohet se: *" Në datën 7.4.2023, z. Bujar Dema, pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, ka publikuar në rrjetin social facebook, një status ku promovon punën e kryetarit të bashkisë Krujë, Artur Bushi duke*

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



"Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023".

promovuar rimandatimin e këtij të fundit si kryetari i ardhshëm i bashkisë Krujë, veprim ky që tregon qartazi përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore brenda orarit të punës për veprimtari dhe aktivitete për qëllime zgjedhore, në kundërshtim me nenin 3, pika 1, shkronja ç dhe nenin 6, pika 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator”

Nëpërmjet e-mail të datës 26.04.2023 është kërkuar Policisë së Shtetit, informacion sqarues në lidhje me denoncimin regjistruar **nr. 332 ID** dhe nëpërmjet e-mail të datës 27.04.2023, jemi informuar se: *“Shtetasi Bujar Dema i cili pretendohet në denoncimin e mësipërm, nuk është punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit.”*

Referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*. Po ky nen parashikon se *“burime”* quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe **çdo burim njerëzor i institucionit**. Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator, në nenin 3 pika 1.3, shkronja “ç”, parashikon **“përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore** qendrore dhe vendore **brenda orarit të punës** për veprimtari dhe/ose aktivitete **për qëllime zgjedhore ...**, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimit, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Gjatë hetimit administrativ nuk u arrit të provohej se personi i denoncuar është punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit. Përsa më sipër, vlerësoj se faktet e administruara për objektin rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për vërtetimin e shkeljes në parashikimet e nenit 91, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- iii. **Denoncimi regjistruar me nr. 333 ID, ndaj Z. Benet Beci kandidat i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë në qarkun Shkodër**, ka promovur projekte me fonde publike, duke l shpërndarë në rrjetin social facebook.
- **Denoncimi nr. 333 ID** më kërkues z. Ivi Kaso nëpërmjet shkresës nr. 135 prot., datë 19.4.2023, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 3965 prot., datë 19.4.2023 ku pretendohet se: *“Z. Benet Beci promovon në rrjetin social Facebook projektin e moleve, i cili po realizohet në kohë fushatë zgjedhore, në Shirokë. Gjithashtu, së bashku me Elisa Spiropalin dhe kreun e Fondin Shqiptar të Zhvillimit z. Dritan Agollin, mbajnë*

takime për projektet e rrugëve në Dukagjin. Benet Beci së bashku me drejtues e punonjës të OSHEE-së promovon punimet në Dobraq, promovon së bashku me kryeministrin z. Edi Rama projektin e Urës së Bunës, në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës zj. Elva Margaritin, z. Benet Beci prezanton bonusin e rijetësimit, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor, vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator dhe urdhërit nr. 46, datë 22.01.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”

Përkatësisht, denoncuesi ka dërguar postimet nga facebook i z. Benet Beci me përmbajtje si më poshtë:

1. Postimi i datës 3 Prill 2023: *“Projekti i moleve i Fondit Shqiptar të Zhvillimit në Shirokë”*
2. Postim i datës 13 Mars 2023: *“Sot së bashku me ministren Elisa Spiropali, prefekten Majlinda Angoni Jubani dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Fondi Shqiptar i Zhvillimit/ Albanian Development Fund Dritan Agolli, organizuam një takim me një përfaqësi të grupit organizator të protestës për rrugën e Dukagjinit. Përsëritëm edhe njëherë angazhimin në mbështetje të kërkesës së tyre të drejtë dhe diskutuam hapat e ndërmarrë deri tani. Megjithëse rruga është në inventarin e bashkisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me financimin e qeverisë shqiptare ka bërë të mundur hartimin e projektit teknik. Prezantimi i projektit dhe diskutimi rreth alternativave të gjurmës së rrugës do të zhvillohet në një takim të zgjeruar në fillim të prillit. Kostoja e konsiderueshme e ndërtimit të kësaj rruge po negociohet si pjesë e paketave të financimit të donatorëve ndërkombëtarë, në kuadër të një programi të madh zhvillimi për rajonin e Shkodrës.*
3. Postim i datës 13 Mars 2023: *“Sot me drejtues e punonjës të OSHEE-së, për të ndjekur nga afër ndërhyrjet në Bexhisten dhe Dobraq. Në Bexhisten do të stakohet linja ajrore 6 kv për të kaluar në një linjë kabllore 20 kv. Ky zëvendësim përmirëson cilësinë e furnizimit duke minimizuar stakimet e energjisë. Afërsisht janë 450 abonentë familjarë që përfitojnë nga kjo ndërhyrje. Ndërsa në Dobraq po ndërtohet një kabinë e re tip box, e cila do të lidhet me linjë 20 kv. Deri tani furnizimi në këtë zonë është bërë me linjë ajrore 6 kv, në gjendje të amortizuar. Gjithashtu do të bëhet zhvillimi i rrjetit me kabllor me vetëmbajtje ABC. Përfitues në këtë zonë janë rreth 220 abonentë. Ditë pozitive me rezultate konkrete e shtrëngime duarsh me banorë e njerëz të punës!”*
4. Postim i datës 28 Shkurt 2023: *“Hapi i parë drejt kthimit të Shkodrës në qendër rajonale zhvillimi”. Ripost i postimit të z. Edi Rama “MIRËMËNGJES dhe me projektin e "Urës mbi Bunë", një projekt i bërë gati për zbatim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili do të bashkëfinancohet nga dy qeveritë, për të lidhur vendet tona duke shkurtuar distancën mes Velipojës e Ulqinit nga 73 km në 300m, si edhe duke i dhënë një shtysë të re lirisë së lëvizjes, turizmit dhe ekonomisë ndërkufitare, ju uroj një ditë të bukur”*
5. Postim i datës 27 Shkurt: *“Podgoricë, Mali i Zi- Nënshkrimi marrëveshjeve ndërqeveritare! Me kryeministrin e Malit të Zi, z. Dritan Abazović, kryebashkiakun e Ulqinit, z. Omer Bajraktari dhe Grupin "Të gjithë bashkë për Shkodrën". #shkodrapozitive”*
6. Postimi i datës 19 Shkurt 2023: *“Ishim sërish bashkë në Shkodër me ministren e Kulturës,*

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

Elva Margariti dhe koleget e qytetarët e shumtë për të prezantuar Bonusin e Rijetësimit, kësaj here thirrjen e dytë që vijon të jetë e hapur. DRTK Shkodër është një derë e hapur për të sqaruar çdo detaj se si mund të aplikoni e cilat kritere duhen plotësuar. Investimet në mbrojtje të trashëgimisë janë një kontributi rëndësishëm për identitetin e Shkodrës dhe një gur themeli drejt qytetit që të gjithë ëndërrojmë. #shkodrapozitive”

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se:

Z. Benet Beci është regjistruar si kandidat për kryetar në bashkinë Shkodër, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, me **vendimin nr. 271 datë 5.4.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Shkodër, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Benet Beci, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”**.

Referuar kërkesës nr. 1072/1 prot, datë 27.03.2023 të Kuvendit të Shqipërisë, e administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 2001 prot., datë 27.3.2023, dorëzimi i mandatit të deputetit nga ana e z. Benet Beci është kryer po në këtë datë.

Z. Beci, për periudhën që janë adresuar denoncimet ka pasur ende statusin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Të ndodhur në këto kushte, për shkak të provave të pamjaftueshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se duhet të pushohet hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19 pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, e pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative për raportimet e kryera në shkelje të afatit ligjor.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura,
 - b. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier,
 - c. Bashkia Tiranë,
 - ç. Bashkia Devoll,
 - d. Bashkia Kavajë,

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.

- dh. Bashkia Libohovë,
 - e. Bashkia Mallakastër
 - ë. Bashkia Tropojë
3. Moskonstatimin e shkëljes dhe pushimin e hetimit administrativ ndaj:
- Z. Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq;
 - Zj. Emiriana Sako, Kryetar i Bashkisë Durrës;
 - Zj. Amarilda Thërrmija, Drejtor i Zyrës Vendore Arsimore, Durrës;
 - Zj. Bora Muzhaqi, Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
 - Artur Bushi, Kryetar dhe kandidat i Bashkisë Krujë;
 - Z. Ervin Demo, Kryetari dhe kandidat i Bashkisë Berat;
 - Z. Blendi Gonxhe, Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
 - Z. Gjon Gjonaj, Kryetar dhe kandidat i Bashkisë Pukë;
 - Z. Nikoll Doda, Oficer i Patrullës së Përgjithshme në Komisaratin e Policisë Kurbin, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë;
 - Z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe Policisë Bashkiake Tiranë;
 - Z. Ermal Kapllani, Drjetor i Ploicisë Bashkiake Tiranë;
 - Kryetar i Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS);
 - Punonjës i administrates, Fier
 - Z. Ardian Gurma, Kryetar i Bashkisë Sarandë;
 - Partisë Socialiste, Njësia 11;
 - Zj. Eglantina Zere, Drejtori i Tirana Parking;
 - Z. Niko Peleshi, Ministër i Mbrojtjes;
 - Zj. Belinda Balluku Zëvendëskryeministër;
 - Z. Bujar Dema;
 - Z. Benet Beci, Kandidat për kryetar në bashkinë Shkodër.
4. Ky vendim t’u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 11.5.2023 Nr. 486
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve dhe denoncimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 28 Prill – 04 Maj 2023”.